

VENDIM
Nr. 125, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1, germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”8; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm.

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit: është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti